



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1658/ Prot.
15

Tiranë, më 08, 09 2026

V E N D I M

Nr. 120 dt. 08, 09 2026

“PËR
NDRYSHIMIN E RREGULLORES “PËR REKRUTIMIN E PERSONELIT AKADEMIK
DHE NDIHMËS AKADEMIK” TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 3, 38, 64, 65, 66 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7, 20, 53, 54, 65 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 7, 33, 43 të Rregullores së UST-së, në shkresën me nr. 1542/1 prot., datë 31.08.2026 “Relacion mbi ndryshimin e rregullores “Për Rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Vendimin e Rektoratit nr. 105, datë 04.09.2026, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.09.2026,

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e Rregullores “Për Rekrutimin e Personelit Akademik dhe Ndhmës Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës” (Bashkëlidhur rregullores).
2. Ky vendim i pëcillet për njohje, zbatim dhe publikim të gjitha njësive përbërëse të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

RREGULLORE
PËR
REKRUTIMIN E PERSONELIT AKADEMIK DHE NDIHMËS
AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Miratur me Vendim nr. 114, datë 30.09.2025 të
Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës, ndryshuar me Vendimin nr.120 datë
08.09.2026

Shtator 2026

MODALITETE

PËR CAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PUNËSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK DHE NDIHMËS AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloret e UST-së, në Strukturën organizative të institucionit dhe nevojat për personel akademik, punësimi i personelit në UST është i hapur, publik dhe procedura e aplikimit dhe konkurrimit të kandidatëve kalon nëpërmjet një procesi transparent e të paanshëm. Kjo procedurë shpallet publikisht dhe është e miratuar nga Senati Akademik, organi më i lartë vendimmarrës i institucionit.

- Vendi i lirë i punës shpallet në faqen zyrtare të institucionit dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike (APP). Për vendin e lirë të punës konkurohet.
- Kriteret e përgjithshme të punësimit përcaktohen në statutin e UST-së.
- Kriteret specifike dhe preferenciale të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori pasi përcillen nga drejtuesi i njësisë kryesore.
- Rektori miraton komisionin *Ad-Hoc* sipas propozimeve të njësisë kryesore dhe cakton një anëtar nga rektorati për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë.
- Komisioni *Ad-Hoc* shqyrton dosjet e kandidatëve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit duke verifikuar përputhshmërinë e informacionit të paraqitur nga kandidati në formularin e aplikimit me dokumentacionin përkatës.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit çertifikon kandidatët që kanë plotësuar të gjithë listën e dokumentave të kërkuara për aplikimin dhe kandidatët që e kanë të plotë dosjen i kalojnë komisionit *Ad-Hoc* për shqyrtimin e vlerësimit të tyre. Gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit dokumentar të dosjeve të paraqitura nga kandidatët, çdo anëtar i komisionit *Ad-Hoc* i vlerëson me pikë në mënyrë të pavarur ato sipas një skeme formulari vlerësimi e cila është standarte.
- Kandidatët që vlerësohen se nuk kanë përputhshmëri të dokumentacionit me deklarinimin që kanë bërë në formularin e aplikimit, ndërpresin garën e konkurimit gjatë kësaj faze.
- Për kandidatët aplikantë që nuk plotësojnë kriterin minimal për të vazhduar garën, komisioni me një vendim të tij nuk i kalon në fazën e dytë të konkurrimit, atë të intervistës.
- Kandidatët që kalojnë pragun minimal, kalojnë në fazën e dytë të vlerësimit nga ana e komisionit, atë të intervistës.
- Burimet Njerëzore njoftojnë elektronikisht kandidatët që kanë kaluar fazën e parë për t’u paraqitur për intervistë në datën dhe orën e caktuar nga komisioni *Ad-Hoc* sipas një grafiku orar. Po ashtu njoftohen edhe kandidatët jo fitues të fazës së parë.
- Pas përfundimit të intervistës anëtarët e komisionit *Ad-Hoc* në mënyrë të pavarur vlerësojnë kandidatët sipas formularit të vlerësimit standart me pikët totale.

- Pas mbledhjes së formularëve të vlerësimit nga çdo anëtar i komisionit *Ad-Hoc*, kryetari i komisionit llogarit mesataren e vlerësimit për çdo kandidat duke i rreshtuar ato në një listë nga kandidati me pikët më të larta deri te kandidati me pikët më të ulëta.
- Rektori shpall fituesin e procedurës sipas listës së paraqitur nga komisioni *Ad-Hoc*.
- Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës në cilësinë e punëdhënësit.
- Vlerësimi i kandidaturave për personel akademik bazohet në plotësimin e kritereve të përgjithshme, specifike dhe preferenciale të kandidateve aplikant sipas pikëzimit total të mëposhtëm:
 - a. Plotësimi i kritereve të përgjithshme është kusht i detyrueshëm;
 - b. Plotësimi i kritereve specifike;
 - c. Plotësimi i kritereve preferenciale;
 - d. Performanca në intervistë.

Totali i pikëve është 100 pikë, nga të cilat 70 pikë nga dosja dhe 30 pikë nga intervista. Kandidati duhet të marrë të paktën 21 pikë nga vlerësimi i dosjes për të kaluar në fazën e intervistës. Në rast se një nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 50 pikë (50% të pikëve totale) komisioni vendos përfundimin e procedurës së këtij kandidati pa u përzgjedhur.

- Në rast se kandidatët janë me pikë të barabarta, atëherë renditja bëhet nëpërmjet shortit.
- Procedura e konkurrimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurrim.

E DREJTA E ANKIMIMIT

- Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *Ad-Hoc*, paraqiten me shkrim tek Rektori së bashku me pretendimet, brenda 2 (dy) ditëve pune nga dita e marrjes së njoftimit mbi rezultatet e konkursit nëpërmjet postës elektronike.
- Ankesa përcillet tek komisioni *Ad-Hoc*. Ankesa zgjidhet brenda 3 (tre) ditëve të punës nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
- Në përfundim, komisioni *Ad-Hoc* merr vendim për pranimin ose rrëzimin e ankesës, vendim i cili i njoftohet kandidatit nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit.
- Nëse ankesa pranohet, Rektori vendos të anullopë procesin si të pavlefshëm duke kërkuar ripërsëritjen e tij.

Mbas kalimit të afatit kohor të paraqitjes së ankesave apo shqyrtimit të tyre, Rektori merr vendim emërimi për fillimin e marrëdhënieve të punës.

A. PROCEDURA E PUNËSIMIT PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

I. SHPALLJA PUBLIKE E KONKURRIMIT:

1. Në web-site të UST-së dhe në Buletin e Njoftimeve Publike bëhet shpallja e konkurrit për punësimin e personelit akademik.
2. Shpallja publike e konkurrit duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - a. pozicioni për vendin vakant;
 - b. numri i personelit të kërkuar për pozicionin/et e kërkuara;
 - c. kriteret të përgjithshme të kualifikimit;
 - d. kriteret specifike të kualifikimit;
 - e. kriteret preferenciale të kualifikimit;
 - f. dokumentet që duhet të dorëzohen;
 - g. mënyrën dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit;
 - h. afatin e zhvillimit të procedurave të konkurrit.

II. KRITERET E KUALIFIKIMIT:

Kriteret e kualifikimit përbëhen nga kriteret të përgjithshme, kriteret specifike dhe kriteret preferenciale të kualifikimit.

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit sipas kategorive të personelit akademik janë si më poshtë:

1. Për personel akademik të kategorisë “Profesor”:

- a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
- b. Të mbajë të paktën titullin shkencor “Profesor i Asociuar”;
(Titulli akademik i lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- c. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- d. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- e. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.

2. Për personel akademik të kategorisë “Lektor”:

- a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
- b. Të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”;
(Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);

- c. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- d. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- e. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.

3. *Për personel akademik të kategorisë “Asistent-Lektor”:*

- a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, “Master i shkencave” ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- b. Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8-të. Nëse njëri nga kandidatët ka mbaruar specilizime afatgjata do të ekuivalentohet nota mesatare me studimet Bachelor, Master i Shkencave dhe Specilizime afatgjata;
- c. Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
- d. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- e. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- f. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.

Kriteret specifike dhe ato preferenciale të kualifikimit të propozuara nga njësia bazë përkatëse i përcillen për miratim Rektorit nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore.

Procedura e konkurimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurim.

III. PROCESI I DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

1. Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë kandidati për konkurim

- a. Aplikimi i plotësuar (formulari tip) dhe firmosja e tij në çdo faqe;
- b. Shprehje e interesit nga ana e kandidatit me shkrim për plotësimin e vendit vakant duke shprehur në të edhe vizionin e tij për këtë pozicion.
- c. Biografi e punës mundësisht me eksperiencat që lidhen me vendin e punës për të cilin aplikon kandidati.
- d. Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
- e. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.

- f. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)/ formulari i vetëdeklarimit.
- g. Letra rekomandimi nga profesorë të fushës.
- h. Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të ndryshme, të noterizuara.
- i. Listë të punimeve shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare profesionale/shkencore dhe/ose punime të tjera, pjesëmarrje në referime shkencore në konferenca etj.; (mundësisht linku i artikullit ose konference. ISBN ose ISSN të artikujve ose botimeve).

2. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dorëzimi i dokumentacionit të plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, mund të bëhet dhe on-line në faqen e UST-së ose me postë sipas afateve të shpallura:

- Në rastin e aplikimit online në faqen zyrtare të UST-së, kandidati është i detyruar që të dorëzojë edhe fizikisht dosjen e tij të aplikimit ditën që do të ftohet për intervistë nëse kalon fazën e parë të aplikimit.
- Kandidati nuk mund të paraqesë asnjë dokument tjetër shtesë përveç atyre që ka aplikuar on-line në web-site të UST-së.
- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen e UST-së dhe APP.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit si dërgues dhe si marrës; *Universiteti i Sporteve të Tiranës, Njësia Kryesore, Njësia Bazë, specialiteti ku aplikon.*

IV. PROCESI I VLERËSIMIT TË KANDIDATURAVE

Vlerësimi i kandidatëve aplikues për personel akademik me kohë të plotë realizohet nga komisioni *Ad-Hoc* i krijuar me urdhër të Rektorit. Hapat e ndjekura në vlerësimin dhe punësimin e personelit akademik me kohë të plotë janë si më poshtë:

1. Krijimi i Komisionit *Ad-Hoc* për punësimin e personelit akademik me kohë të plotë

- Komisioni *Ad-Hoc* për konkursin e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë krijohet nga Rektori.
- Komisioni *Ad-Hoc* për konkursin e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë është në numër tek. Përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë, të cilët janë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë dhe që nuk duhet të kenë konflikt interesi me kandidatët pjesëmarrës. Komisioni përbëhet nga:
 - o Tre anëtarë propozohen nga drejtuesi i njësisë bazë, për të cilin është shpallur procedura e konkurimit.

- Një anëtar propozohet nga drejtuesi i njësisë kryesore i cili ka shpallur procedurën e konkurimit;
- Një anëtar propozohet nga Rektorati i UST-së.
- Caktimi i anëtarëve të komisionit *Ad-Hoc* dhe pjesëmarrja e tyre në komision është e detyrueshme.
- Komisioni *Ad-Hoc* e ushtron funksionin e tij me një përbërje të plotë dhe në çdo rast me jo më pak se pesë anëtarë.
- Drejtuesi i njësisë kryesore (dekani/ drejtori) si rregull kryeson Komisionin *Ad-Hoc*.

2. Detyrat e komisionit *Ad-Hoc*

- Komisioni, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpashnjëshme, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Komisioni pas zhvillimit të intervistës, shpall kandidatin/ kandidatët fitues. Konkurimi zhvillohet në mjediset e UST-së ku dhe shpallen kandidatët fitues.
- Kryetari i Komisionit njoftohet me Urdhrin për ngritjen e tij dhe listën e kandidatëve aplikues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit ditën e shpalljes së urdhrit. Kryetari dhe anëtarët e komisionit diskutojnë e vendosin për datën dhe orën për vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve sipas kriterëve të miratuara dhe tabelës së vlerësimit duke listuar kandidatët e përzgjedhur për të vazhduar fazën e dytë të konkurimit.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit njofton kandidatet fitues të fazës së parë të kandidimit për t'u paraqitur për intervistë pranë ambjenteve të UST-së në ditën dhe orën e caktuar nga komisioni *Ad-Hoc*.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore njofton kandidatët që nuk e kanë kaluar fazën e parë të kandidimit që ndërpresin garën e konkurimit në këtë fazë.
- Procesi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve realizohet nga komisioni *Ad-Hoc* brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga dita e hapjes së fazës së parë të konkursit.
- Komisioni në prani të të gjithë anëtarëve shqyrton dosjet e kandidatëve duke evidentuar dhe kryer vlerësimin në mënyrë të pavarur sipas anekseve bashkëlidhur kësaj rregulloreje, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur për secilin kandidat.
- Komisioni pas evidentimit të dokumentacionit dhe vlerësimit merr vendim për kandidaturat që do të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e dytë.
- Komisioni realizon pikëzimin e dokumentacionit të paraqitur për secilin kandidat dhe merr vendim për zhvillimin e intervistave.
- Komisioni merr vendim për kandidatët e skualifikuar duke renditur arsyet e skualifikimit për secilin prej tyre.
- Komisioni realizon dhe vlerëson intervistat si dhe informon çdo kandidat për pikëzimin e dokumentacionit të tij para intervistës.
- Komisioni vlerëson kandidatët në intervistën e strukturuar për:

- o Aftësitë shprehëse për mënyrën e paraqitjes së filozofisë së mësimdhënies/kërkimit shkencor nga ana e kandidatit.
 - o Prezantimin në PowerPoint (ppt) dhe referimin e një temë leksioni apo kërkimi shkencor që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë (mini – leksion/prezantim).
 - o Të jetë i gatshëm t'i përgjigjet pyetjeve të ndryshme rreth fushës së studimit.
 - o Kandidati duhet të jetë i përgatitur që mund të intervistohet edhe në gjuhën të cilën ai ka të çertifikuar në aplikim.
- Kualifikimi i kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e shpallura publikisht.
 - Vlerësimi bëhet sipas një sistemi pikësh të përcaktuar paraprakisht dhe të standartizuara sipas një formati tip, nga secili prej anëtarëve dhe më pas bëhet integrimi i vlerësimeve.
 - Komisioni pas zhvillimit të intrvistës, rendit kandidaturat sipas pikëzimit total.
 - Komisioni vendos dhe propozon renditjen përfundimtare për Rektorin.
 - Komisioni *Ad-Hoc* i paraqet listën me renditjen e kandidatit/ kandidatëve pjesëmarrës në konkurs Rektorit të UST-së përmes drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori bën shpalljen e kandidatit/ kandidatëve fitues, nënshkruan kontratën e punës me të/ta dhe nga ky moment fillojnë marrëdhëniet e punës.
3. Pikëzimi i dokumentacionit të kandidatëve konkurues dhe koeficientët është sipas anekseve të pasqyruara në këtë rregullore.

4. Periudha e zhvillimit të procedurave të konkurimit

Kjo periudhë zgjat jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë pune nga koha e ngritjes së urdhrat të komisionit ad hoc. Gjatë kësaj periudhe komisioni ka realizuar vlerësimin paraprak të dokumentacionit si dhe intervistat. Kandidati njoftohet elektronikisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit për vendimet e marra nga komisioni për kohën, vendin datën e mënyrën e zhvillimit të intervistës.

5. Shpallja e fituesit:

- Shpallja e fituesit bëhet nga Rektori pas miratimit dhe klasifikimit përfundimtar.
- Kandidatët njoftohen elektronikisht për rezultatin nga Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit me e-mail. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit njofton kandidatin fitues, harton kontratat e punës si dhe njësia përkatëse harton akt-marrëveshjen.
- Aplikantëve u garantohet e drejta të ankimojnë vlerësimin dhe rezultatet e konkursit, duke paraqitur kërkesë formale dhe duke parashtruar arsyet dhe shkaqet për të cilat paraqesin ankimin, brenda 2 ditëve të punës nga shpallja e rezultateve. Ankimi paraqitet tek Rektori i UST-së, i cili e shqyrton dhe vendos mbi ankimin për rishikim nga komisioni i ankimeve.
- Në rast të konstatimit të parregullsive në zbatimin e procedurave dhe të vlerësimit, Rektori vendos pavlefshmërinë e procesit dhe ripërsëritjen e tij.
- Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.

ANEKSI I

LENDË: Krite të vlerësimit të kandidatit/ve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik në

Departamentin

Fakultetit të.....

A. KATEGORIA: “Asistent Lektor”

I. KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2	Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8. Nqse njëri nga kandidatët ka mbaruar specilizime afatgjata do të ekuivalentohet nota mestare me studimet Bachelor, Master i Shkencave dhe Specilizime afatgjata.
3	Të ketë notë mesatare mbi 8-të në studimet e nivelit “Bachelor”, DIND, Master Shkencor dhe Specializime afatgjata, si dhe specialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë mbi 8. Për çdo 0.1 notë më shumë se 8.00, shtohet me 0.5 pikë në vlerësim, gjithsej 10 pikë.
4	Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht) të fitura konform legjislacionit në fuqi.
5	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
6	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
7	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.
Shënim: Në rast mosplotësimi të kriteve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.	

II. KRITERE TË VEÇANTA

II	KRITERE PËR VLERËSIM	Vlerësimi (pikë)
1	Shkollimi:	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Të ketë notë mesatare mbi 8-të në studimet e nivelit “Bachelor”, DIND, Master Shkencor dhe Specializime afatgjata. (për çdo 0.1 notë = 0.5 pikë) përjashtuar rastet sipas pikës 7, VKM nr.57, datë 29.01.2020 (vertetuar nga ministria përkatëse)	
2	Përvojë pune në fushën e studimit dhe mësimdhënie	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Për çdo vit eksperience në mësimdhënie me kohë të plotë në universitet (1 vit = 2 pikë, por jo më shumë se 5 vjet).	
	Për çdo vit eksperience në mësimdhënie me kohë të pjesshme në universitet (1 vit = 1 pikë, por jo më shumë se 5 vjet)	
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit	<i>Deri në 5 pikë</i>
	Kurs kualifikimi brenda vendit në fushën e profesionit, i vërtetuar me dëshmi (1 kurs = 0.5 pikë, të njohura zyrtarisht, deri në 5 pikë)	
	Kurs kualifikimi jashtë vendit në fushën e profesionit i vërtetuar me dëshmi (1 kurs = 1 pikë dhe të njohura zyrtarisht)	

4	Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës. (Vlerësohen me pikë kualifikimet 3 muaj e më shumë).	
	Kualifikime brenda vëndit (3 muaj = 2 pikë)	Deri në 10 pikë
5	Kualifikime jashtë vëndit të njohura zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë (3 muaj = 4 pikë).	
	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht) e vërtetuar me dëshmi nga kurset intern (nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri).	Deri në 5 pikë
6	niveli C1 = 3 pikë, B2 = 2 pikë, gjuha e dytë = 2 pikë	
	Referime në:	Deri në 8 pikë
7	Konferenca, kongrese, simpoziume brenda vëndit, numër pjesëmarrjesh (çertifikatë): 1 pjesëmarrje = 1 pikë, por jo më shumë se 4 pikë. Pjesëmarrje me botim "Proceedings" të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të njohura zyrtarisht në RSH: autor i parë ose i dytë = 2 pikë; autor i tretë në vijim = 1 pikë)	
	Konferenca, kongrese, simpoziume, jashtë vëndit, me botim në "Proceedings" të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës; autor i parë ose i dytë = 3 pikë; autor i tretë në vijim = 1 pikë)	
8	Botime artikuj shkencor:	Deri në 12 pikë
	Botime brenda vëndit: autor i parë ose i dytë = 2 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë)	
9	Botime jashtë vëndit: a) botimet në revistat e indeksuara ndërkombëtare marrin: autor i parë ose i dytë = 3 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë.	
	PROJEKTE: drejtues/ anëtar	Deri në 10 pikë
10	Projekt kombëtar: drejtues projekti = 5 pikë; anëtar projekti = 2 pikë.	
	Projekt ndërkombëtar: drejtues projekti = 7 pikë; anëtar projekti = 3 pikë.	
Totali i Pikëve të Dosjes = 70 pikë		70 pikë
II Intervista me Gojë, Pikë = 30 pikë		30 pikë
TOTALI PIKËVE = totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës		

Kujdes & Konsideroni:

- Vlerësimi me pikë do të rrumbullakoset, fiksohet 0.6, që do të kalojë një njësi më lart:
Shembull 8.15 = 0.5 pikë dhe 8.16 = 1 pikë.
- Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktoratë jashtë vëndit).

ANEKSI II

Lënda: Krite të vlerësimit të kandidatit/ve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik në

Departamentin

Fakultetit të.....

B. KATEGORIA: “LEKTOR”

I. KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës
2	Të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”. (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
3	Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht; minimumi niveli B2) të fitura konform legjislacionit në fuqi.
4	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
5	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
6	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

II. KRITERE TË VEÇANTA

I	KRITERE PËR VLERËSIM	Vlerësimi (pikë)
1	Shkollim:	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Doktoratë jashtë vendit (në vendet e BE & OECD) (brenda fushës që kandidon) = 10 pikë .	
	Doktoratë brenda vendit (brenda fushës që kandidon) = 8 pikë .	
2	Të ketë përvojë pune në mësimdhënie:	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Për çdo vit eksperience në mësimdhënie me kohë të plotë në universitet	
	1 vit = 2 pikë , por jo më shumë se 5 vjet.	
3	Për çdo vit eksperience në mësimdhënie me kohë të pjesshme në universitet	
	1 vit = 0.5 pikë , por jo më shumë se 5 vjet.	
	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit	<i>Deri në 10 pikë</i>
3	Kurs kualifikimi brenda vendit në fushën përkatëse, i vërtetuar me dëshmi	
	1 kurs = 1 pikë .	
	Kurs kualifikimi jashtë vendit në fushën përkatëse i vërtetuar me dëshmi	
4	1 kurs = 2 pikë .	
	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht) e vërtetuar me dëshmi nga kurset intern. Legjislacioni në fuqi. Nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri.	<i>Deri në 5 pikë</i>

	niveli C1 = 3 pikë, B2 = 2 pikë, gjuha e dytë = 2 pikë	
	Botime:	15 pikë
	Tekst mësimor të aprovuar nga departamenti përkatës (autor i parë ose i dytë), vlerësohet deri në 2 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
5	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar brenda vendit (autor i parë ose i dytë) vlerësohet deri në 3 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit (autor i parë ose i dytë) vlerësohet deri në 4 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit të indexuar <u>SCOPUS</u> / ose me faktor impakti të indeksuara (autor i parë ose i dytë) vlerësohet deri në 5 pikë; autor i tretë e në vijim = 2 pikë	
	Referime në:	Deri në 10 pikë
6	Konferenca, kongrese, simpoziume brenda vendit, numër pjesëmarrjesh me botim të plote në "Proccedings" të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të njohura zyrtarisht në RSH; " (autor i parë ose i dytë), vlerësohet me 2 pikë; autor i tretë e në vijim 1 pikë	
	Konferenca, kongrese, simpoziume, jashtë vendit, me botim të plotë në "Proccedings" të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës; (autor i parë ose i dytë), vlerësohet me 3 pikë, autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
7	PROJEKTE = drejtues/ anëtar	Deri në 10 pikë
	Projekt kombëtar: drejtues projekti = 4 pikë; anëtar projekti = 2 pikë.	
	Projekt ndërkombëtar: drejtues projekti = 6 pikë; anëtar projekti = 3 pikë.	
	Totali Pikëve të Dosjes = 70 pikë	70 pikë
II	Intervista me Gojë, pikë = 30 pikë	30 pikë
	TOTALI PIKËVE = totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës	

Kujdes & Konsideroni:

- Vlerësimi me pikë do të rrumbullakoset, fiksohet 0.6, që do të kalojë një njësi më lart:
Shembull 8.15 = 05 pikë dhe 8.16 = 1 pikë
Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktorate jashtë vendit).

ANEKSI III

LËNDA: Krite të vlerësimit të kandidatit/ve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik në

Departamentin

Fakultetit të.....

C. KATEGORIA: “Profesor”

I. KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2	Të mbajë të paktën titullin shkencor “Profesor i Asociuar”. (Titulli akademik i lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
3	Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht; minimumi niveli B2) të fitura konform legjislacionit në fuqi.
4	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
5	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
6	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

II. KRITERE TË VEÇANTA

I	KRITERE PËR VLERËSIM	Vlerësimi (pikë)
1	Shkollimi:	<i>Deri në 15 pikë</i>
	Titulli “Profesor”, vlerësimi = 15 pikë	
	Titulli “Profesor i Asociuar”, vlerësimi = 10 pikë	
2	Të ketë përvojë pune në mësimdhënie:	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Për çdo vit eksperience në mësimdhënie me kohë të plotë në universitet 1 vit = 2 pikë, por jo më shumë se 5 vjet.	
	Për çdo vit eksperience në mësimdhënie me kohë të pjesshme në universitet 1 vit = 0.5 pikë, por jo më shumë se 5 vjet.	
3	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht) e vërtetuar me dëshmi nga kurset intern. Legjislacioni në fuqi. Nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri.	<i>Deri në 5 pikë</i>
	niveli C1 = 3 pikë, B2 = 2 pikë, gjuhë të tjera = 2 pikë	
4	Botime:	<i>Deri në 20 pikë</i>
	Tekst mësimor të aprovuar nga departamenti përkatës (autor i parë ose i dytë), vlerësohet deri në 2 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë	

	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar brenda vendit (autor i parë ose i dytë) vlerësohet deri në 3 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit (autor i parë ose i dytë) vlerësohet deri në 4 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit të indexuar <u>SCOPUS</u> / ose me faktor impakti të indeksuara (autor i parë ose i dytë) vlerësohet deri në 5 pikë; autor i tretë e në vijim = 2 pikë	
	Referime në:	<i>Deri në 10 pikë</i>
5	Konferenca, kongrese, simpoziume brenda vendit, numër pjesëmarrjesh me botim të plotë në “ Proccedings ” të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të njohura zyrtarisht në RSH; ” (autor i parë ose i dytë), vlerësohet me 2 pikë, autor i tretë e në vijim 1 pikë	
	Konferenca, kongrese, simpoziume, jashtë vendit, me botim të plotë në “ Proccedings ” të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës; (autor i parë ose i dytë), vlerësohet me 4 pikë, autor i tretë e në vijim 2 pikë.	
	PROJEKTE = drejtues/ anëtar	<i>Deri ne 10 pikë</i>
6	Projekt kombëtar: drejtues projekti = 4 pikë; anëtar projekti = 2 pikë.	
	Projekt ndërkombëtar: drejtues projekti = 6 pikë; anëtar projekti = 3 pikë.	
	Totali i Pikëve të Dosjes = 70	
II	Intervista me Gojë, Pikë = 30	30 pikë
	TOTALI PIKËVE = totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës	

B. LËVIZJET PARALELE PËR STAFIN AKADEMIK

1. Lëvizja paralele e personelit akademik për nevojat emeregjente të njësive kryesore (fakulteteve) në Universitetin e Sporteve të Tiranës, lejon transferimin e një punonjësi brenda universitetit në një pozicion të të njëjtit nivel, për plotësimin e nevojave emergjente të një njësie baze (departamenti), edhe pa pasur nevojë për një konkurs të hapur publik të jashtëm.

1.1. Nismat dhe arsyetimi i nevojës emergjente

- Drejtuesi i njësisë bazë (departamentit) që ka nevojë për staf, i drejton një kërkesë të argumentuar Dekanit të Fakultetit, i cilë pas miratimit e përcjell këtë kërkesë pranë Rektorit të UST- së.
- Rektori i UST-së shprehet me vendim për këtë lëvizje paralele pasi të ketë marrë miratimin me shkrim nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe të stafit akademik që kërkohet të lëvizë.

2. Lëvizja paralele e personelit akademik për nevojat e njësive kryesore (fakulteteve) në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për secilin pozicion të lirë bëhet me konkurs të hapur publik brenda Universitetit.

2.1. Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë lidhen me plotësimin e kushteve dhe kërkesave specifike dhe preferenciale të përcaktuara nga njësia bazë ku është krijuar vendi i lirë.

Kriteret specifike dhe preferenciale të personelit akademik me kohë të plotë (lëvizje paralele) përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Drejtuesi i njësisë kryesore dhe Rektori i UST-së.

Procedura e konkurrimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurim.

2.2. Shpallja e vendit të lirë të punës përmban këto të dhëna:

- a. Pozicionin për vendin vakant;
- b. Përshkrimin e përgjithshëm të punës për atë pozicion;
- c. Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret specifike dhe ato preferenciale që duhet të plotësojnë kandidatët;
- d. Dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
- e. Afatet e dorëzimit;
- f. Numri i personelit të kërkuar për pozicionin/et e kërkuara;
- g. Kritere të përgjithshme të kualifikimit;
- h. Afatin e zhvillimit të procedurave të vlerësimit të dosjeve të kandidatit.

2.3. Shpallja është e hapur për të gjithë punonjësit akademik të UST-së të së njëjtës kategori.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për vlerësim të kandidaturave pranë zyrës së Arkiv/Protokollit të UST-së. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati

i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 5 ditë pune nga data e parë e shpalljes së vendit të lirë të punës në ambjentet dhe web-site të UST-së.

- 2.3. Vlerësimi i dosjeve të kandidatëve që kandidojnë për një vend të lirë për personel akademik (lëvizje paralele) të UST, bëhet nga komisione të posaçme (Ad-Hoc). Dekanët/Drejtorët i secilit fakultet/institut paraqesin në Rektorat përbërjen e komisioneve të vlerësimit të kandidatëve, për secilin specialitet, i cili i nënshtrohet miratimit. Komisionet përbëhen nga të paktën 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 1 (një) përfaqësues i Rektoratit, 2 (dy) nga njësia kryesore dhe 2 (dy) të tjerë nga njësiti bazë.
- 2.4. Komisionet në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit marrin në shqyrtim paketat e aplikimit të kandidatëve, brenda 2 (dy) ditëve të punës nga data e krijimit të tij, si dhe verifikojnë përputhshmërinë e informacionit të formularit të aplikimit dhe dokumentacionin përkatës. Kandidatët njoftohen elektronikisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit rreth fokusit të intervistës.
- 2.5. Komisioni në prani të gjithë anëtarëve hap dosjet e kandidatëve duke evidentuar i vlerësuar me pikë nga çdo anëtar i komisionit *Ad-Hoc* për çdo rubrikë të formularit tip të vlerësimit (në mënyrë të pavarur). Kjo mbledhje e komisionit dokumentohet me proces verbal.
- 2.6. Komisioni pas evidentimit dhe vlerësimit në baze të dokumentacionit merr vendim për kandidaturat duke i listuar ato sipas pikëve.
- 2.7. Klasifikimi i kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e shpallura. Eksperienca dhe formimi i kandidatëve të klasifikuar, duhet t'i përgjigjen sa më mirë përshkrimit të vendit të punës.
- 2.8. Vlerësimi bëhet sipas një sistemi pikësh të përcaktuar paraprakisht në formularin e vlerësimit, nga secili prej anëtarëve të komisionit *Ad-Hoc* dhe më pas bëhet integrimi i vlerësimeve.
- 2.9. Komisioni, në përfundim të vlerësimit, rendit kandidatët sipas pikëve të fituara në rendin zbritës dhe përcjell në Rektorat listën përfundimtare me Vendimin për kandidatin fitues.
- 2.10. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit, njofton konkurentët për rezultatin e tyre, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve në mënyrë elektronike.
- 2.11. Kandidati që nuk është fitues, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim për rezultatin e pikëve, brenda 2 (dy) ditëve të punës nga data e njoftimit për rezultatin e vlerësimit. Ankimuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve të punës nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
- 2.13. Njësia përgjegjëse, brenda 2 (dy) ditëve të punës, pas përfundimit të procedurave të ankimit, shpall fituesin dhe bën aktin e emërimit të kandidatit nga Rektori.
- 2.14. Personeli akademik detyrohet të bëjë dorëzimet në pozicionin e mëparshëm të punës brenda 5 (pesë) ditëve pune.

C. PROCEDURA E PUNËSIMIT PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS (TË JASHTËM)

Për nevoja të Departamenteve në Universitetin e Sporteve të Tiranës për mbulimin e procesit mësimor e më gjërë, krahas personelit me kohë të plotë, punësohet edhe personel akademik me kohë të pjesshme. Punësimi i personelit akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Sporteve realizohet me konkurs. Konkursi zhvillohet në njësinë përkatëse.

Hapat e ndjekura në punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme janë si më poshtë:

- Njësitë kryesore, me propozim të njësive bazë, të cilat përcaktojnë nevojat e tyre për personel akademik joefektiv, i kërkojnë Rektorit miratimin e personelit akademik me kontratë të përkohshme. Ky propozim mund të realizohet vetëm nëse ngarkesa mësimore nuk plotësohet me personelin akademik me kohë të plotë. Rektori, duke u mbështetur në propozimet e njësive kryesore dhe në varësi të fondit të miratuar për këtë qëllim, miraton çdo vit listën emërore të personelit akademik me kontratë të përkohshme.
- Kjo kontratë do të nënshkruhet nga Rektori për një punë të caktuar ose për një periudhë kohe të caktuar.

Njësitë kryesore dhe njësitë bazë në propozimet e tyre duhet të marrin për bazë përvojën profesionale dhe akademike të kandidatëve. Ata duhet që të plotësojnë minimalisht këto kritere:

- a. Në programin “Bachelor”, duhet të kenë përfunduar studimet në programin “Master i Shkencave”
- b. Në programin “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, duhet të kenë gradën shkencore “Doktoratë”
- c. Në programin e shkollës së Doktoratës, duhet të jenë pjesë e kategorisë “Profesor”;

I. SHPALLJA PUBLIKE E KONKURRIMIT:

1. Në web-in e UST-së bëhet shpallja e konkurimit për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme. Njoftimi për nevojën për personel akademik bëhet publik nga Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Arkiv/ Protokollit nëpërmjet faqes zyrtare të UST-se.
2. Shpallja publike e konkurimit duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - a. pozicioni për vendin vakant;
 - b. numri i personelit të kërkuar për pozicionin/et e kërkuara;
 - c. kritere të përgjithshme të kualifikimit;
 - d. kritere specifike të kualifikimit;
 - e. kriteret preferenciale;
 - f. dokumentet që duhet të dorëzohen;

- g. mënyrën dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit;
- h. Afatin e zhvillimit të procedurave të vleresimit të kandidatëve.

II. KRITERET E KUALIFIKIMIT:

Kriteret e kualifikimit përbëhen nga kriteret të përgjithshme, kriteret specifike dhe kriteret preferenciale të kualifikimit.

Kandidatët që konkurojnë për personel akademik me kohë të pjesshme, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme, specifike dhe preferenciale sipas kategorisë përkatëse.

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit janë si më poshtë:

1. *Për personel akademik i kategorisë “Profesor”:*

- a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
- b. Të mbajë të paktën titullin shkencor “Profesor i Asociuar”.
(Titulli akademik i lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
- c. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në përcaktimin e kriterëve të punësimit për staf akademik me kohë të plotë në UST;
- d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
- e. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
- f. Të ketë veprimtari kërkimore-shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse.
- g. Të plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse.

2. *Për personel akademik i kategorisë “Lektor”:*

- a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
- b. Të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
- c. (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri); Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në përcaktimin e kriterëve të punësimit për staf akademik me kohë të plotë në UST;
- d. Të ketë të paktën 2 vite përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit.
- e. Të ketë veprimtari kërkimore-shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse.
- f. Të plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse.

- g. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
- h. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;

3. *Për personel akademik i kategorisë "Asistent-Lektor".*

- a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri):
 - d.1. Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8, si dhe specialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë mbi 8.
 - d.2. Përfshihen nga kërkesa e pikës d.1), vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në aktivitetet mësimore praktike (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
- b. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në përcaktimin e kriterëve të punësimit për staf akademik me kohë të plotë në UST;
- c. Të zotërojnë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht)
- d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
- e. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;

Kriteret specifike dhe ato preferenciale të kualifikimit të propozuara nga njësia bazë përkatëse i përcillen për miratim Rektorit nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore.

Procedura e konkurimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurrim.

III. PROCESI I DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

1. *Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë kandidati për konkurim*

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botim shkencore;
- d) Kopje e noterizuar diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;

- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)/ formulari i vetdeklarimit;
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (nqs është i punësuar, e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.(dorëzohet nëse shpallet fitues)
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

2. *Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit*

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurimit në njoftimin publik, duhet të dorëzohet në adresën e përcaktuar në njoftim që është:

- Dorëzimi i dokumentacionit bëhet nëpërmjet rrugës postare:
- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të aplikimit elektronik ose shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit (dërguesi); pastaj sipas renditjes (marrësi) 1) Universiteti i Sporteve të Tiranës, 2) Njësia Kryesore, 3) Njësia bazë, 4) **specialiteti ku aplikon** (lënda), emri, mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

3. *Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët*

Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve punës nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare ose të gjithë paketën me dokumenta e dërgon elektronikisht në web-site të UST .

IV. PROCESI I VLERËSIMIT TË KANDIDATURAVE

Vlerësimi i kandidatëve aplikues për personel akademik me kohë të pjesshme realizohet nga komisioni *ad hoc* i krijuar me urdhër të dekanit.

Konkurimi për personel akademik me kontratë të përkohëshme bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjeve nga njësia bazë. Pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet një dosje nqs kandidati plotëson kriteret. Përfundim të rastet kur personeli akademik me kontratë të përkohëshme është kategoria "Profesor", të cilët duhet të paraqesin: CV të plotë; dokumentin zyrtarë që vërteton titullin akademik. Në rast të pjesëmarrjes në konkurs të më shumë se 1 (një) kandidati, është intervista që bën diferencën.

Pikëzimi i dokumentacionit të kandidatëve konkurrues dhe koeficientët është sipas aneksit IV, V dhe VI të pasqyruara në këtë rregullore.

ANEKSI IV

LENDË: Kriteria të vlerësimit të kandidatëve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik me kohë të pjesshme në

Dep.....

Fakultetit të

A. KATEGORIA: “Asistent Lektor”

I. KRITERE TE PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëzuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2	Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8, si dhe specialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë mbi 8. - Për çdo 0.1 notë më shumë se 8.00, shtohet me 0.5 pikë në vlerësim, gjithsej 10 pikë. - Përfshihen nga kërkesa vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në aktivitetet praktika mësimore (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
3	Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht). Përfshihen nga kërkesa e pikës 5, vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në aktivitetet mësimore (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
4	Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në percaktimin e kriterëve të punësimit për staf akademik me kohë të plotë në UST;
5	Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
6	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

II. KRITERE TE VEÇANTA

I	KRITERE PËR VLERËSIMIN NE (PIKË) DHE RENDITJEN E KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
	Shkollim:	<i>Deri në 10 pikë</i>
1	Të ketë notë mesatare mbi 8-të në studimet e nivelit “Bachelor”, DIND, Master Shkencor dhe Specializime afatgjata. (për çdo 0.1 notë = 0.5 pikë).	
	Pervojë pune në fushën e studimit dhe mësimdhënie	<i>Deri në 10 pikë</i>
2	Per çdo vit eksperience në mësimdhënie me kohë të plotë në universitet, (1 vit = 2 pikë , por jo më shumë se 5 vjet)	
	Për çdo vit eksperiencë në mësimdhënie me kohë të pjesshme në universitet (1 vit = 1 pikë , por jo më shumë se 5 vjet)	
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit	<i>Deri në 5 pikë</i>

	Kurs/ trajnime kualifikimi brenda vendit në fushën e profesionit, i vërtetuar me dëshmi (1 kurs = 05 pikë, të njohura zyrtarisht, deri në 5 pikë)	
	Kurs/trajnime kualifikimi jashtë vendit në fushën e profesionit i vërtetuar me dëshmi (1 kurs = 1 pikë dhe të njohura zyrtarisht)	
4	Kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës. (Vlerësohen me pikë kualifikimet 3 muaj e më shumë).	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Kualifikime brenda vëndit (3 muaj = 1 pikë)	
	Kualifikime jashtë vëndit të njohura zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë (3 muaj = 1 pikë)	
5	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht) e vërtetuar me dëshmi nga kurset intern (nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri).	<i>Deri në 5 pikë</i>
	niveli C1 = 3 pikë; B2 = 2 pikë; B1 = 1 pikë; gjuhë e dytë (nga 5 gjuhët e BE) = 2 pikë	
	Referime në:	<i>Deri në 8 pikë</i>
6	Konferenca, kongrese, simpoziume brenda vendit , të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, numër pjesëmarrjesh në "Proccedings": autor i parë ose i dytë = 2 pikë ; autor i tretë në vijim = 1 pikë, por jo me shumë se 4 pikë	
	Konferenca, kongrese simpoziume jashtë vendit , në "Proccedings" të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës me kod ISBN ose ISSN të vendeve të OECD-së, BE- së ose G20-ës: (autor i parë ose i dytë = 3 pikë ; autor i tretë në vijim = 1 pikë)	
	Botime:	<i>Deri në 12 pikë</i>
7	Botime brenda vendit : të njohura zyrtarisht në RSH, (autor i parë ose i dytë = 2 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë)	
	Botime jashtë vendit : a) botimet në revistat e indeksuara në SCOPUS autor i parë ose i dytë = 3 pikë; autor i tretë e në vijim = 2 pikë	
	b) botimet në revistat Ndërkombëtare të indeksuara; autor i parë ose i dytë = 3 pikë; autor i tretë e në vijim = 2 pikë	
8	PROJEKTE: drejtues/ anëtar	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Projekt kombëtar: drejtues projekti = 5 pikë ; anëtar projekti = 2 pikë .	
	Projekt ndërkombëtar: drejtues projekti = 7 pikë ; anëtar projekti = 3 pikë .	
	Totali Pikëve të Dosjes = 70	70 pikë
II	Intervista me Gojë, Pikë = 30	30 pikë
	TOTALI PIKËVE = totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës	

Kujdes & Konsideroni:

- Vlerësimi me pikë do të rrumbullakoset, fiksohet 0.6, që do të kalojë një njësi më lart: Shembull 8.15 = 05 pikë dhe 8.16 = 1 pikë
- Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktoratë jashtë vendit).

ANEKSI V

Lënda: Krite të vlerësimit të kandidatëve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik me kohë të pjesshme në

Departamentin

Fakultetit të.....

B. KATEGORIA: “LEKTOR”

I. KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2	Të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”. (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
3	Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron.
4	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
5	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
6	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

II. KRITERE TË VEÇANTA

I	KRITERE PËR VLERËSIM	Vlerësimi (pikë)
1	Shkollim:	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Doktoratë jashtë vendit (në vendet e BE & OECD) (brenda fushës që kandidon) = 10 pikë.	
	Doktoratë brenda vendit (brenda fushës që kandidon) = 8 pikë.	
2	Të ketë përvojë pune në mësimdhënie:	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Për çdo vit eksperience në mësimdhënie me kohë të plotë në universitet 1 vit = 2 pikë, por jo më shumë se 5 vjet.	
	Për çdo vit eksperience në mësimdhënie me kohë të pjesshme në universitet 1 vit = 0.5 pikë, por jo më shumë se 5 vjet.	
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit	<i>Deri në 10 pikë</i>
	Kurs kualifikimi brenda vendit në fushën përkatëse, i vërtetuar me dëshmi 1 kurs = 1 pikë.	
	Kurs kualifikimi jashtë vendit në fushën përkatëse i vërtetuar me dëshmi 1 kurs = 2 pikë.	
4	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht) e vërtetuar me dëshmi nga kurset intern. Legjislacioni në fuqi. Nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri.	<i>Deri në 5 pikë</i>
	niveli C1 = 3 pikë, B2 = 2 pikë, gjuha e dytë = 2 pikë	

	Botime:	15 pikë
	Tekst mësimor të aprovuar nga departamenti përkatës (autor i parë ose i dytë), vlerësohet deri në 2 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
5	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar brenda vendit (autor i parë ose i dytë) vlerësohet deri në 3 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit (autor i parë ose i dytë) vlerësohet deri në 4 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit të indexuar <u>SCOPUS</u> / ose me faktor impakti të indeksuara (autor i parë ose i dytë) vlerësohet deri në 5 pikë; autor i tretë e në vijim = 2 pikë	
	Referime në:	Deri në 10 pikë
6	Konferenca, kongrese, simpoziume brenda vendit, numër pjesëmarrjesh me botim të plotë në “Proccedings” të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të njohura zyrtarisht në RSH; ” (autor i parë ose i dytë), vlerësohet me 2 pikë; autor i tretë e në vijim 1 pikë	
	Konferenca, kongrese, simpoziume, jashtë vendit, me botim të plotë në “Proccedings” të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës; (autor i parë ose i dytë), vlerësohet me 3 pikë, autor i tretë e në vijim = 1 pikë	
	PROJEKTE = drejtues/ anëtar	Deri në 10 pikë
7	Projekt kombëtar: drejtues projekti = 4 pikë; anëtar projekti = 2 pikë.	
	Projekt ndërkombëtar: drejtues projekti = 6 pikë; anëtar projekti = 3 pikë.	
	Totali Pikëve të Dosjes = 70 pikë	70 pikë
II	Intervista me Gojë, pikë = 30 pikë	30 pikë
	TOTALI PIKËVE = totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës	

Kujdes & Konsideroni:

- Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Dokorate jashtë vendit).

ANEKSI VI

LËNDA: Kriteria të vlerësimit të kandidative për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik me kohë të pjesshme në

Departamentin

Fakultetit të.....

C. KATEGORIA: “Profesor”

I. KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2	Të mbajë të paktën titullin shkencor “Profesor i Asociuar”. (Titulli akademik i lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
3	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
4	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
5	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

II. KRITERE TË VEÇANTA

I	KRITERE PËR VLERËSIMIN NE (PIKË) DHE RENDITJEN E KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
1	Shkollim dhe kualifikim të mëtejshëm:	<i>Deri në 70 pikë</i>
	Titulli “Profesor”, vlerësimi = 70 pikë	
	Titulli “Profesor i Asociuar”, vlerësimi = 60 pikë	
Totali Pikëve të Dosjes = 70 pikë		
II	Intervista me Gojë, Pikë = 30 pikë	30 pikë
TOTALI PIKËVE = totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës		

Procedura

Hapat e ndjekura në vlerësimin dhe punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme janë si më poshtë:

1. Krijimi i Komisioni *Ad-Hoc* për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme

- Listat me dokumentacionin e kandidatëve aplikues të secilit departament përcillet në njësinë bazë me proces verbal nga punonjësja e Sektorit të Arkiv/Protokollit.
- Komisioni *Ad-Hoc* për konkursin e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme krijohet nga drejtuesi i njësisë kryesore (dekani). Anëtarët e komisionit përcaktohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe përcillen tek Dekani.
- Komisioni *Ad-Hoc* për konkursin e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme është numër tek.
- Drejtuesi i njësisë bazë (drejtuesi i departamentit) kryeson Komisionin *Ad-Hoc*.
- Në komision mund të marrë pjesë edhe një përfaqësues nga Rektorati pa të drejtë vote.

2. Detyrat e komisionit *Ad-Hoc*

- Kryetari i Komisionit *Ad-Hoc* të çdo departamenti, njoftohet me Urdhrin për ngritjen e tij dhe listën e kandidatëve aplikues ardhur nga Dekani ditën e shpalljes së urdhrit. Kryetari dhe anëtarët e komisionit diskutojnë e vendosin për datën dhe orën për vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve sipas kritereve të miratuara dhe tabelës së vlerësimit.
- Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi, Komisioni realizon detyrat e tij vlerësimin e kandidaturave nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti.
- Komisioni në prani të gjithë anëtarëve hap dosjet e kandidatëve duke evidentuar me proces verbal dokumentacionin e paraqitur për secilin kandidat.
- Komisioni pas evidentimit të dokumentacionit merr vendim për kandidaturat që do të vazhdojnë më tej konkurimin.
- Komisioni realizon pikëzimin e dokumentacionit të paraqitur për secilin kandidat dhe merr vendim për zhvillimin ose jo të një interviste duke njoftuar elektronikisht kandidatët.
- Komisioni merr vendim edhe për kandidatët e skualifikuar duke renditur arsyet e skualifikimit për secilin dhe i njofton ato elektronikisht.
- Në rastet e realizimit të intervistave, Komisioni informon çdo kandidat për pikëzimin e dokumentacionit të tij.
- Nëse komisioni vlerëson që të ftojë kandidatët në intervistën e strukturuar, ata vlerësohen për:
 - o Aftësitë shprehëse për mënyrën e paraqitjes së veprimtarisë së punës kërkimorë/shkencore.
 - o Prezantimin dhe referimin e një temë që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë nga ana akademike.
 - o Të qënurit i gatshëm t'i përgjigjet pyetjeve të ndryshme rreth fushës së studimit.
 - o Komisioni mund të vendosë që intervistën ta zhvillojë edhe në gjuhën që kandidati ka të certifikuar.
- Komisioni, rendit kandidaturat sipas pikëzimit total në rendin zbritës.

- Njësia bazë është përgjegjëse për ruajtjen dhe arkivimin e dosjes së kandidatit fitues, ndërsa dosjet e kandidatëve që nuk janë shpallur fitues të kthehen me proces-verbal në zyrën e Arkiv/ Protokollit për t'u tërhequr nga kandidatët kundrejt një kërkesë me shkrim. Zyra e Arkiv/ Protokollit, në rast se tërhiqet origjinali ruan një kopje të dokumentave.
- Komisioni vendos dhe propozon renditjen përfundimtare për miratim nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore dhe Rektori.

Shënim:

- *Kandidatët njoftohen elektronikisht nga Departamenti ku aplikon.*
- *Vlerësimi në total është 100 pikë nga të cilat 70 pikë janë nga kriteret e paracaktuara më sipër dhe 30 pikë nga intervista.*

3. Periudha e zhvillimit të procedurave të konkurrimit

Kjo periudhë zgjat 5 (pesë) ditë pune nga koha e ngritjes së urdhrit të komisionit *Ad-Hoc*. Gjatë kësaj periudhë komisioni ka realizuar vlerësimin e kandidateve sipas dokumentacionit si dhe intervistat nëse komisioni *Ad-Hoc* ka gjykuar që duhet t'i thërrasë kandidatët për një intervistë të strukturuar. Kandidati njoftohet elektronikisht nga Njësia bazë për vendim marrjen dhe renditjen në listen e hartuar nga Komisioni *Ad-Hoc* si edhe për orën dhe vendin ku do të mbahet intervista nëse është gjykuar që do të ketë një te tillë.

3. Shpallja e fituesit:

- Shpallja e fituesit bëhet nga rektori pas miratimit dhe klasifikimit përfundimtar. Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni ad hoc paraqiten brenda 2 (dy) ditëve të punës te Rektori. Për shqyrtimin e ankesave Rektori ngre një komision të posaçëm të përbërë nga 3 (tre) anëtarë. Ankesa zgjidhet brenda 3 (tre) ditëve të punës nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
- Kandidatët njoftohen elektronikisht për rezultatin nga Njësia bazë. Në rast të konstatimit të parregullsive në zbatimin e procedurave, Rektori vendos pavlefshmërinë e procesit dhe ripërsëritjen e tij.
- Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.

D. PERSONELI AKADEMIK I FTUAR

1. Departamentet kanë të drejtë të ftojnë studiues e personalitete të shkencës dhe sportit, vendas ose të huaj, për qëllime akademike dhe kërkimore-shkencore që të kontribuojnë për periudha të shkurtra kohe. Personeli i ftuar përbëhet kryesisht nga punonjës me tituj shkencorë, por edhe sportistë elitare ose personalitete të shquar në fushat e studimit ku ofrohet programi i studimit.
2. Personeli akademik i ftuar përzgjidhet nga lista e personave që propozohen në departamentet përkatëse, duke pasur parasysh formimin e tyre akademik apo përvojën profesionale në një fushë të caktuar, që u shërben nevojave konkrete të mësimdhënies ose kërkimit shkencor.
3. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar bëhet nga njësia kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë, pasi të jenë identifikuar modulet ku do të angazhohen, vëllimi i orëve mësimore/kërkimore shkencore (leksione/ seminare, laboratore, projekte kërkimore etj.) që ata do të kryejnë, si dhe kualifikimi apo cilësitë e veçanta të personalitetit që propozohet si kandidat. Njësia bazë duhet të përpilojë një relacion të detajuar justifikues.
4. Personeli akademik i ftuar propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe Rrektori i UST-së.

Procedurë për Rekrutimin e Personelit Akademik të Ftuar në Fushën e Sporteve – Personalitete të Shkencës dhe Praktikës Sportive

1. Qëllimi

Kjo procedurë synon përfshirjen në mënyrë të strukturuar të figurave të njohura shkencore dhe profesionale në fushën e sporteve, me qëllim ngritjen e cilësisë akademike dhe zhvillimin praktik të studentëve në programet e edukimit fizik, trajnimit sportiv dhe shkencave të sportit.

2. Kriteret për Përzgjedhje

Personi i ftuar mund të jetë:

- Personalitet me titull shkencore dhe kërkime të njohura në shkencat e sportit.
- Trajner i nivelit të lartë kombëtar/ndërkombëtar dhe ish-sportist i nivelit elitare.
- Ekspert me kontribute në zhvillimin e politikave sportive apo teknologjive të sportit.

3. Hapat e Procedurës

3.1 Identifikimi i Nevojës

- Njësia përkatëse paraqet kërkesën pranë Dekanit të Fakultetit:
 - o Fusha ku kërkohet ekspertiza (relacion argumentues)
 - o Objektivat e angazhimit.

3.2 Propozimi i Kandidatit

- Kërkesa duhet të përfshijë:
 - o Emrin e kandidatit;
 - o CV të detajuar;
 - o Kontributet relevante (publikime, medalje, trajnime, konferenca);
 - o Llojin e angazhimit (leksione, seminare, praktikë, projektet kërkimore, konsulencë).

3.3 Vlerësimi dhe Miratimi

- Komision *ad hoc* i përkohshëm me përfaqësues të:
 - o Departamentit përkatës;
 - o Përfaqësues të Dekanatit.
 - o Përfaqësues të Rektoratit.
- Ky komision përgatit raportin vlerësues dhe ia paraqet Rektorit për miratim.

3.4 Marrëveshja e Bashkëpunimit

- Pasi miratohet kandidatura, përgatitet një marrëveshje që përfshin:
 - o Afatet e angazhimit (modul semestral, workshop i përkohshëm, projektet kërkimore, detyrimet mësimore ose trajnimi praktik etj.);
 - o Kompensimi apo mbulimi i shpenzimeve (që parashikohet në VKM me nr.748, datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pakë të punonjësve të personelit akademik të Institucioneve publike të arsimit të lartë”, pika 9).

4. Llojet e Angazhimit

- Lektor i ftuar në kurse specifike
- Mentor për punime të diplomës apo kërkime shkencore ;
- Koordinator praktikash sportive me ekipe dhe organizata;
- Organizator konferencash, workshopesh, seminarësh, trajnimesh intensive, etj.

5. Kontrata e personelit akademik të ftuar bëhet nga Rektori i UST-së, pasi të jetë miratuar më parë në Bordin e Administrimit.

6. Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e universitetit.

FORMULAR I KËRKESËS
PËR PUNËSIM SI PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË/ TË PJESSHME
(Udhëzim: Plotësoni formularin vetëm me kompjuter. Firmosni në fund formularin e kërkesës, pasi formulari i pafirmosur nuk pranohet.)

Fakulteti: _____
Departamenti: _____

I. TË DHËNA PERSONALE

Mbiemri:
Emri:
Emri i babait:
Datëlindja: (data) _____ (muaji) _____ (viti)
Vendlindja (qyteti/shteti):
Shtetësia:
Gjinia: ☐ Mashkull ☐ Femër
Vendi i lëshimit:

Adresa e përhershme:	Adresa e përkohshme (nëse keni të tillë)
Rruga:	Nga data: _____ deri më _____
Nr.:	Rruga:
Qyteti/Shteti:	Nr.:
Telefon:	Qyteti/ Shteti:
E-mail:	Telefon:
Fax:	E-mail:
	Fax:

II. TË DHËNA PËR STUDIMET

2.1. TË DHËNA PËR STUDIMET BACHELOR OSE EKVIVALENTE ME TË

Ju lutemi shënoni në rend kronologjik, nisur nga viti më i afërt të gjitha studimet

Emërtimi i diplomës dhe profili	Fusha	Kredite të fituara	Nota mesatare e përgjithshme /e ponderuar	Data e lëshimit të diplomës	Institucioni që e ka lëshuar diplomën	Qyteti/shteti

2.2. TË DHËNA PËR STUDIMET MASTER OSE EKVIVALENTE ME TË

Ju lutemi shënoni në rend kronologjik, nisur nga viti më i afërt të gjitha studimet

Emërtimi i diplomës dhe profili	Fusha	Kredite të fituara	Nota mesatare e përgjithshme/ e ponderuar	Data e lëshimit të diplomës	Institucioni që e ka lëshuar diplomën	Qyteti/shteti

2.3. TË DHËNA PËR GRADËN SHKENCORE “DOKTOR”

Ju lutemi shënoni në rend kronologjik, nisur nga viti më i afërt të gjitha studimet

Emërtimi i diplomës	Fusha	Tema e disertacionit	Institucioni që e ka lëshuar diplomën	Data e lëshimit të diplomës

III. TË DHËNA PËR TITULLIN AKADEMIK

Emërtimi i titullit akademik	Numri i dëshmisë	Institucioni që ka lëshuar titullin	Data e lëshimit të dëshmisë

IV. TË DHËNA PËR PUNËSIMIN

Ju lutemi shënoni në rend kronologjik, nisur nga viti më i afërt, të gjithë përvojën tuaj të punës deri në këtë vit kalendarik.

Qendra e punës	Pozicioni juaj	Qyteti/shteti	Vite pune

V. ZOTËRIMI I GJUHËVE TË HUAJA

5.1. Shënoni nivelin dhe pikët që dëshmojnë zotërimin e e *Gjuhës Angleze* sipas testit ndërkombëtar që keni kryer:

Lloji i testit	Niveli CEF	Cambridge ESOL	IELTS band	TOEFL I BT	TOEIC	Michigan Test	PTE General
Vlerësimi							

5.2. Tjetër certifikatë/ vlerësimi:

5.3. Shënoni nivelin e zotërimit të gjuhëve të tjera të huaja sipas shkallës (shumë mirë/ mirë/ mjaftueshëm/ dobët).

Gjuha	Leximi	Të folurit	Të shkruarit	Lloji i certifikatës
Frëngjisht				
Gjermanisht				
Italisht				
Tjetër:				
Tjetër:				

VI. BOTIMET

6.1. ARTIKUJ SHKENCORË

Ju lutemi renditini kronologjikisht duke filluar nga viti më i afërt.

Nr.	Titulli i artikullit	Titulli i revistës	Numri/ viti, vendi i botimit	Statusi i revistës			Statusi i autorit	
				Me bord editorial (po/jo)	Me ISSN (po/jo) (shëno ISSN)	Me faktor impakti mbi (po/jo) (Shëno faktorin)	Autor i parë (po/jo)	Bashkautor (po/jo)
1.								
2.								
3.								
4.								
5.								

6.2. MONOGRAFI

Ju lutemi renditini kronologjikisht duke filluar nga viti më i afërt.

Nr.	Titulli i monografisë	Viti i botimit	Vendi i botimit	Me miratim nga departamenti (po/jo)	Me ISBN (po/jo) (Shëno numrin)	Gjuha		Statusi i autorit	
						Në gjuhën shqipe (Shëno X)	Në gjuhë të huaj (Shëno X)	Autor i parë (po/jo)	Bashkautor (po/jo)
1.									
2.									
3.									

6.3. TEKSTE UNIVERSITARE

Ju lutemi renditini kronologjikisht duke filluar nga viti më i afërt.

Nr.	Titulli i monografisë	Viti i botimit	Vendi i botimit	Me miratim nga departamenti (po/jo)	Me ISBN (po/jo) (Shëno numrin)	Gjuha		Statusi i autorit	
						Në gjuhën shqipe (Shëno X)	Në gjuhë të huaj (Shëno X)	Autor i parë (po/jo)	Bashkautor (po/jo)
1.									
2.									
3.									

VII. PJESEMMARRJA NË KONFERENCA SHKENCORE

Ju lutemi renditini kronologjikisht duke filluar nga viti më i afërt.

Nr.	Titulli i kumtesës së mbajtur	Titulli i konferencës	Organizatori i konferencës	Vendi i zhvillimit	Data/Viti i zhvillimit	Botimi në proceedings(po/jo) me ISBN (shëno)
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						
7.						
8.						

VIII. PËRVOJË MËSIMDHËNIE OSE KËRKIMI NË UNIVERSITETE TË HUAJA

Institucioni	Detyra e kryer	Qyteti/shteti	Periudha kohore

IX. PJESEMMARRJA NË PROJEKTE KËRKIMI SHKENCOR

Ju lutemi renditini kronologjikisht duke filluar nga viti më i afërt.

Nr.	Titulli i projektit	Institucioni që e realizon	Statusi në projekt	Viti i zhvillimit
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

X. PËRVOJA SI MËSIMDHËNËS

Nr.	Titulli i lëndës/modulit	Programi i studimit	Titullar (po/jo)	Institucioni	Periudha kohore
1.					
2.					
3.					
4.					

XI. LISTË E MATERIALEVE TË PËRGATITURA MËSIMORE (SKRIPTË, LEKSIONE, UDHËZUES PRAKTIKASH OSE USHTRIMESH)

Nr.	Lloji i materialit	Lënda	Programi i studimit	Viti i zhvillimit
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

XII. QËLLIMI I KËRKESËS

12.1. Shënoni tre arsye pse doni të punësoheni në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

12.2. Prezantoni filozofinë tuaj të mësimdhënies me rreth 10 fjali.

12.3. Prezantoni se cilat janë planet tuaja të kërkimeve dhe të botimeve me rreth 10 fjali

Unë i nënshkruari/e nënshkruara, _____, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se i gjithë informacioni i njoftuar prej meje në këtë formular dhe dokumentacioni që i bashkangjitet atij është i vërtetë dhe i plotë. Unë jam i/e vetëdijshëm/me se informacioni i pavërtetë është një arsye e mjaftueshme për mohimin e të drejtës së pranimi dhe për të më hequr të drejtën e statusit të fituar të personelit akademik nëse pavërtetësia zbulohet më vonë.

Pranoj që çdo njoftim lidhur me këtë kërkesë të më bëhet nëpërmjet postës elektronike (e-mail)

Nënshkrimi _____

Data _____

XIV. LISTËKONTROLLI

Sigurohuni nëse ju i keni mbledhur dhe i keni dorëzuar të gjitha dokumentet për kërkesën tuaj duke plotësuar kutizat e mëposhtme.

- ☐ Formular i plotësuar i kërkesës
- ☐ Biografi profesionale
- ☐ Kopje e noterizuar e Diplomës Bachelor ose ekuivalente me të/suplement
- ☐ Kopje e noterizuar e Diplomës Master ose ekuivalente me të/suplement
- ☐ Kopje e noterizuar e Diplomës së gradës shkencore "Doktor" ose (e_albania)
- ☐ Kopje e noterizuar e dëshmisë së titullit akademik ose (e_albania)
- ☐ Kopje e noterizuar e dëshmisë së zotërimit të gjuhës së huaj (obligatore për kandidatet që konkurojnë në kategorinë "Asistent Lektor").
- ☐ Listë e artikujve shkencorë
- ☐ Listë e monografive e shoqëruar me fotokopjet e faqes së parë të botimit.
- ☐ Listë e teksteve universitare e shoqëruar me fotokopjet e faqes së parë të botimit.
- ☐ Listë e pjesëmarrjeve në konferenca e shoqëruar me programin, dëshminë e konferencës dhe fotokopje të botimit në proceedings.
- ☐ Listë e materialeve të përgatitura mësimore (skripte, leksione, udhëzues praktikash ose ushtrimesh).
- ☐ Listë e projekteve kërkimore dhe vërtetimi i pjesëmarrjes.
- ☐ Rekomandime pune .
- ☐ Dëshmi/vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.

XV. KOMENT PËR DOKUMENTACIONIN

I plotë ☐

Me mangësi ☐

Komente për mangësitë:

Tiranë, më _____

Nënshkrimi i Punonjësit të DBNJAP

Shënim: Në seksionin e treguesit të notes mesatare të përgjithshme është obligator për t'u plotësuar nga kandidatet që konkurojnë për kategorinë "Asistent Lektor".



Shtojca nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI/ INSTITUTI.....
KOMISIONI AD-HOC

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2026

V E N D I M

Nr. _____ Datë _____

**PËR REZULTATET E VLERËSIMIT TË KONKURSIT PËR PUNËSIMIN E PERSONELIT
AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË/TË PJESSHME
NË DEPARTAMENTIN E _____**

Komisioni *Ad-Hoc* për përzgjedhjen e personelit akademik për Departamentin e _____ i
ngritur në zbatim të Vendimit Nr.....datë, për përzgjedhjen e personelit akademik me kohë të
plotë/të pjesshme të Rektorit të UST-se, pasi vlerësoi dokumentacionin e kandidatëve dhe kreu intervistat
ballë për ballë me ta,

V E N D O S I:

Të rendisë kandidatët sipas pikëve të fituara, si më poshtë vijon:

Kategoria Profesor

1. _____ pikë

Kategoria Lektor

1. _____ pikë

Kategoria Asitent-lektor

1. _____ pikë

Bashkëngjitur do të gjeni skedën e vlerësimit.

Komisioni Ad-Hoc

E. PROCEDURA E PUNËSIMIT PËR PERSONEL NDIHMËS AKADEMIK ME KARAKTER MËSIMOR /ADMINISTRATIV NË UST.

1. Rekrutimi i personelit ndihmës akademik bëhet me konkurs si dhe për raste urgjente dhe specifike rekrutimet mund të procedohen me kërkesë të argumentuar të drejtuesit direkt. Në të gjitha rastet personeli ndihmës akademik duhet të plotësojë kritere të përgjithshme dhe kritere të veçanta të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Punësimi në Universitetin e Sporteve të Tiranës bëhet me konkurim publik, duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.
3. Marrja në punë e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor/administrativ kryhet me konkurim publik.
4. Nisja e procedurës së punësimit me konkurs publik për personelin ndihmës akademik me karakter mësimor/administrativ në UST, vendoset me urdhër të Rektorit, pas marrjes së propozimeve nga drejtuesi i njësive kryesore/drejtorive përkatëse në rastin e vendeve të lira në këto njësi.
5. Vlerësimi i kandidaturave për personel ndihmës akademik bazohet në plotësimin e kritereve të përgjithshme, specifike dhe preferenciale të kandidateve aplikant sipas pikëzimit total të mëposhtëm:
 - a. Plotësimi i kritereve të përgjithshme është kusht i detyrueshëm;
 - b. Plotësimi i kritereve specifike;
 - c. Plotësimi i kritereve preferenciale;
 - d. Performanca në intervistë.
6. Totali i pikëve të dosjes 70 pikë + intervista 30 pikë = 100 pikë
 - Në rast se një nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 50 pikë (50% të pikëve totale) komisioni vendos përfundimin e procedurës së këtij kandidati pa u përzgjedhur.
 - Në rast se kandidatët janë me pikë të barabarta, atëherë renditja bëhet nëpërmjet shortit.
 - Procedura e konkurimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurim.

Bazuar në Strukturën e përgjithshme të institucionit dhe nevojat për personel ndihmës akademik në UST zhvillohet procedura e punësimit si më poshtë:

I. KRITERET E KUALIFIKIMIT:

Kriteret e kualifikimit përbëhen nga kritere të përgjithshme dhe kritere të veçanta të kualifikimit.

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit janë si më poshtë:

1. Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës:
 - o Kandidati duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit parë ose të dytë në fushën e kërkuar. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përvojë të mëparshme pune;
4. Të mos jetë marrë masa disiplinore e largim nga puna, e cila nuk është shuar sipas ligjit në fuqi;
5. Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
6. Të mos ketë dëmtuar imazhin e UST-së.

Kriteret specifike dhe preferenciale të kualifikimit propozohen nga njësia përkatëse dhe miratohen nga Rektori.

Procedura e konkurimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurim.

ANEKSI VII

Kritere të vlerësimit të kandidatëve për konkurim për vend të lirë pune për personel ndihmës akademik me karakter administrativë “Drejtore Drejtorie” ose “Përgjegjës Sektori” pranë Drejtorisë _____ në UST.

A. Personel ndihmes akademik “Drejtore” ose “Përgjegjës Sektori”

I. KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1.	- Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. - Kandidati duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit parë dhe të dytë ose DIND, në fushën e kërkuar. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
2.	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3.	Të ketë përvojë të mëparshme pune;
4.	Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
5.	Të mos ketë dëmtuar imazhin e UST-së;
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve me sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

II. KRITERE TË VEÇANTA

II	KRITERE PËR VLERËSIMIN NË (PIKË) DHE RENDITJEN E KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
1	Të zotërojë Diplome të studimeve universitare	30 pikë
	Të ketë notë mesatare mbi 7-të në studimet e nivelit “Bachelor dhe Master Shkencor” ose DIND (për çdo 0.1 notë = 1 pikë)	
2	Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron.	20 pikë
	Të ketë përvojë pune: - 1 vit = 4 pikë, por jo më shumë se 5 vjet, 20 pikë	
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit:	10 pikë
	Kurs kualifikimi brenda vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër, për çdo kurs 1 pikë)	
	Kurs kualifikimi jashtë vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër) 2 pikë.	
4	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, etj.) e vërtetuar me dëshmi.	10 pikë
	Niveli B1 = 2 pikë; B2 = 5 pikë; C1 = 8 pikë.	
	Gjuhë e dytë = 2 pikë.	
TOTALI PIKËVE 70 pikë		
II	Intervista me gojë 30 pikë	30 pikë
TOTALI PIKËVE = Dosja + Intervista		

ANEKSI VIII

Kritere të vlerësimit të kandidatëve për konkurim për vend të lirë pune për personel ndihmes akademik me karakter administrative dhe ndihmës akademik me karakter mësimor “Specialist/e” pranë Dekanatit ose Drejtorive në UST-së

B. Personel “ndihmes akademik me karakter administrativ ose mësimor” “Specialist”

KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1.	Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron.
2.	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale me dashje.
3.	Të mos ketë cënuar imazhin e UST-së.
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve me sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

Tabela e pikëzimit për personelin ndihmes akademik me karakter administrativ ose mësimor “Specialist”.

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Arsimi përkatës (max 25)	Eksperiencia në punë (max 15)	Trajnime & Certifikime (max 30)	Intervista (max 30)	Totali (max 100)
1.						
2.						
3.						
4.						

II. PROCESI I DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

1. Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë kandidati për konkurim.

- a. Plotësimi i formularit të aplikimit.
- b. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- c. Një kopje jetëshkrimi;
- d. Kopje e noterizuar e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin;
- e. Kopje e noterizuar e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- f. Dëshmi penaliteti/formular i vetëdeklarimit;
- g. Certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme të noterizuara;
- h. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë.
- i. Fotokopje të librezës së punës e noterizuar ose vërtetim nga institucioni ku ka punuar për vitet e punës.
- j. Deri në 2 (dy) referenca nga punëdhënësi të mëparshëm.

III. SHPALLJA PUBLIKE E KONKURIMIT:

1. Në web-site te UST-se dhe Buletin e Njoftimeve Publike bëhet shpallja e konkurimit për punësimin e personelit ndihmës akademik në UST.
2. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët të jetë **10 (dhjetë)** ditë pune nga data e publikimit të njoftimit.
3. Shpallja publike e konkurrimit duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - a. fushën kryesore mbi të cilën do të bazohet konkurrimi, si dhe aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim;
 - b. përshkrimin e përgjithshëm të punës për të cilin do të zhvillohet konkurrimi;
 - c. kritere të përgjithshme të kualifikimit;
 - d. kritere specifike të kualifikimit;
 - e. kriteret preferenciale të kualifikimit;
 - f. dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
 - g. afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
 - h. datën e daljes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak të kandidatëve;
 - i. datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet faza e dytë e konkurrimit;
 - j. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në fazën e verifikimit paraprak, si dhe në fazën e vlerësimit të kandidatëve;
 - k. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

IV. KONKURIMI

1. Kandidaturat e paraqitura për konkurim vlerësohen nga një Komision *ad hoc* i krijuar me urdhër të Rektorit.
2. Komisioni i vlerësimit të kandidaturave për vendet e lira të personelit ndihmës akademik në nivel njësie kryesore ngrihet me vendim të Rektorit pas propozimit të dhënë nga drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse dhe ka në përbërjen e tij jo më pak se 3 (tre) anëtarë, 1(një) prej të cilëve i përket njësisë kryesore ku është i lirë pozicioni, 1(një) i përket njësisë bazë dhe 1(një) anëtar përfaqësues i Rektoratit.
3. Komisioni i vlerësimit të kandidaturave për vendet e lira të personelit ndihmës akademik në nivel institucioni ngrihet me vendim të Rektorit dhe ka në përbërje të tij jo më pak se 3(tre) anëtarë, 1 (një) nga zëvendësrektorët, i cili është kryetar i komisionit dhe 1(një) përfaqësues nga drejtoria ku është i lirë vendi i punës dhe 1(një) përfaqësues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit.
4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit në koordinim edhe me Komisionin *Ad Hoc* njofton për datën e zhvillimit të kësaj faze dhe për listën e kandidatëve.
5. Komisioni *Ad-Hoc* shqyrton dosjet e kandidatëve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/ Protokollit duke verifikuar përputhshmërinë e informacionit të paraqitur nga kandidati në formularin e aplikimit me dokumentacionin përkatës.
6. Procedura e konkurimit zhvillohet si më poshtë:
 - a. Vlerësimi i kandidatëve kalon në dy faza:
 - o Verifikimi paraprak mbështetur në dokumentacion e paraqitur nga kandidatët, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme, specifike dhe preferenciale të përcaktuara në shpalljen për konkurim;
 - o Komisioni harton listën paraprake të fituesve të kësaj faze.
 - o Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit njofton kandidatët fitues të kësaj faze për t'u paraqitur në fazën e dytë të konkurimit, atë të intervistës. Gjithashtu edhe kandidatët jo fitues të kësaj faze njoftohen në mënyrë elektronike për vendimin e komisionit Ad Hoc i cili është shprehur për mospërshtatshmërinë e tyre në vazhdimin e garës në fazën e dytë.
 - b. Vlerësimi i kandidatëve që kalojnë fazën e verifikimit paraprak:
 - o Anëtarët e komisionit *Ad-Hoc* në mënyrë të pavarur dhe individuale bëjnë vlerësimin e dosjeve të kandidateve dhe paraqitjes së tyre në interviste duke i pikëzuar sipas një skede vlerësimi në praninë e të gjithë Komisionit;
 - o Kandidatët që kane kaluar fazën e parë, paraqiten për intervistë në datën dhe orën e njoftuar elektronikisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit.

- o Anëtarët e Komisionit *Ad-Hoc* pas përfundimit të intervistës të çdo kandidati që ka kaluar fazën e parë bëjnë vlerësimin edhe të kësaj faze me pikë sipas skedës të vlerësimit. Këto pikë i shtohen pikëve të fituara nga faza e parë (vlerësimi i dokumentave) dhe në këtë mënyrë kemi një vlerësim total me pikë për kandidatin.
 - o Skedat e vlerësimit të pikëzuar nga çdo anëtar i komisionit *Ad-Hoc* përmbledhen në një listë duke vënë vlerësimin e tyre mesatar (të nxjerrë nga mesatarja e thjeshtë e vlerësimeve të pikëve të çdo anëtari të komisionit *Ad-Hoc*).
 - o Komisioni *Ad-Hoc* pasi ka hartuar listën e kandidatëve të renditur në rend zbritës ia dërgon atë Rektorit ;
 - o Njoftimi i rezultateve të konkurimit bëhet në rrugë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit.
 - o Brenda 2 (dy) ditëve të punës nga njoftimi i rezultatit të konkurrimit, kandidati ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Rektorit të UST-së. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.
5. Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:
- a. vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;
 - b. vlerësimi i dokumentacionit lidhur me kriteret e përgjithshme, specifike dhe preferenciale;
 - c. intervista e strukturuar me gojë.
6. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, në rast se një nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 50 pikë (50% të pikëve totale) komisioni vendos përfundimin e procedurës së këtij kandidati pa u përzgjedhur.
7. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

FORMULAR APLIKIMI

Për Pozicionin: Personel ndihmës akademik me karakter administrativ ose mësimor në UST

Të dhënat personale

Emri: _____
 Mbiemri: _____
 Data e lindjes: _____
 Vendbanimi: _____
 Numri i telefonit: _____
 E-mail: _____

Kualifikimet Arsimore

Niveli i Arsimit	Institucioni	Drejtimi/Programi	Vitet e studimit	Nota mesatare

Eksperienca Profesionale (nëse ka)

Pozicioni	Institucioni	Përshkrim i shkurtër i detyrave	Koha e angazhimit

Aftësi të tjera dhe kualifikime shtesë

Shënoni gjuhë të huaja, njohuri kompjuterike, trajnime të ndjekura, etj.

Letër Interesi (motivuese)

Shkruani shkurtimisht pse jeni të interesuar për këtë pozicion dhe çfarë mund të kontribuoni në institucion.

DOKUMENTACIONI QË BASHKËNGJITET ME APLIKIMIN

- ☐ Formular aplikimi.
- ☐ CV profesionale
- ☐ Kopje e noterizuar e Diplomës Bachelor ose ekuivalente me të.
- ☐ Kopje e noterizuar e listës së notave të studimeve Bachelor ose ekuivalente me të.
- ☐ Kopje e noterizuar e Diplomës Master ose ekuivalente me të.
- ☐ Kopje e noterizuar e listës së notave të studimeve Master ose ekuivalente me të.
- ☐ Kopje e noterizuar e dëshmisë së zotërimit të gjuhës së huaj (nëse ka).
- ☐ Letër motivimi.
- ☐ Rekomandime pune.
- ☐ Dëshmi/vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore
- ☐ Dokument identifikimi
- ☐ Dëshmi për eksperiencë pune/trajnime (nëse ka)

DEKLARATË

Deklaroj se të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe të sakta.

Data: ____/____/____

Nënshkrimi: _____

V. LËVIZJET PARALELE DHE NGRITJA NË DETYRË PËR STAFIN NDIHMËS AKADEMIK NË UST

- Lëvizjet e brëndshme të stafit ndihmës akademik (lëvizje paralele) dhe ngritja në detyrë bëhen pa konkurim nëse plotësojnë kriteret për pozicionin e lirë. Këto lëvizje të brëndshme për secilin pozicion propozohen nga Rektori / Dekani / Drejtori i Njesisë Kryesore / Drejtuesi i Njesise Bazë si dhe bazuar në nevojat e drejtorive përkatëse dhe gjithnjë kërkojnë dakortësinë e personelit dhe miratimin e Rektorit.
- Për lëvizjet paralele dhe ngritjen në detyrë kanë përparësi kandidatët që plotësojnë këto kriterë sipas dosjes personale:
 - a. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
 - b. Të ketë vlerësimin e fundit "Shumë mirë".
 - c. Të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit së bashku me dy anëtarë që përcakton Rektori verifikon dosjen dhe informon Rektorin që kandidati plotëson kushtet e kërkuara. Në rastet kur një vend vakant për pozicionin e lirë nuk plotësohet nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë atëhere shpallet procedura e konkurimit.
- Lëvizjet e brëndshme të stafit ndihmës akademik në staf administrativ dhe anasjelltas (lëvizjet paralele) dhe ngritja në detyrë bëhen pa konkurim nëse plotësojnë kriteret për pozicionin e lirë. Këto lëvizje të brëndshme propozohen nga Administratori bazuar në nevojat e drejtorive dhe miratohen nga Rektori i Universitetit të Sporteve të Tiranës.
- Personeli ndihmës akademik për secilin pozicion që lëviz detyrohet të bëjë dorëzimet në pozicionin e mëparshëm të punës brenda 5 (pesë) ditëve të punës.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
PROF. DR. AGRON KASË**

